

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, relatore e trupit gjykues, kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit znj.Edina Kurti, duke parashtruar arsyetimin tim në pakicë lidhur me sa vijon:

1.Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për sa i përket apartamentit të banimit me sip. 127 m², ndodhur në Lagjen *, Durrës.**

1.1.Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e rivlerësimit vetting, ka deklaruar në pronësi të saj dhe bashkëshortit 2/3 të kësaj pasurie të paluajtshme duke deklaruar edhe vlerën e tij prej 9.784.983 lekësh.,

1.2.Subjekti ka deklaruar se ka paguar vetëm shumën 2.000.000 lekë nga gjendja *cash* e mbledhur në shtëpi nga të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni dhe kursime familjare, dhe pjesa tjetër në vlerat 2.486.400 lekë dhe 5.298.583 lekë janë paguar nga nëna e bashkëshortit e cila zotëron vetëm 1/3 pjesë në këtë pasuri.

1.3.Nga rrethanat e hetimit, rezulton që subjekti e bashkëshorti janë pronarë të 2/3 pjesë të pronësisë së apartamentit objekt hetimi administrativ, duke paguar vetëm 1/5 e vlerës së tij, ndërsa nëna e bashkëshortit të subjektit, pronare e 1/3 pjesë të tij, ka paguar 4/5 vlerë të këtij apartamenti në vlerat 2.486.400 lekë dhe 5.298.583 lekë.

1.3.1.Nga sa më sipër rezulton se secili prej bashkëpronarëve nuk ka investuar në përputhje me pjesët takuese, duke passjellë situatën faktike parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 sipas të cilit nëna e bashkëshortit të subjektit si person tjetër i lidhur, ka detyrimin për justifikimin e burimeve të ligjshme lidhur me pagesat e bëra nga ajo për këtë pasuri.

1.3.2.Gjithashtu nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti, e pyetur se cila ka qenë adresa e banimit të prindërve të bashkëshortit për periudhën 2011 – 2016, ka deklaruar se: *“Deri në nëntor të vitit 2012 prindërit e bashkëshortit tim kanë jetuar në adresën L. ***, rr. ***, Bulevardi ***, nr. ***, Durrës. Nga data 18.11.2012 deri në datën 7.6.2013 kanë qëndruar në Kanada tek vajza A. H.. Pas kthimit nga Kanadaja dhe deri në vitin 2016, sipas pyetjes, kanë jetuar në apartamentin në pronësi të shtetases A. T., të ndodhur në Bulevardin *** Durrës. Vlera monetare që kanë paguar ka qenë 5.000 lekë/muaj dhe këtë shpenzim e kanë mbuluar me të ardhurat dhe kursimet e tyre”.*

1.3.3.Nga hetimi administrativ, ndryshe nga sa ka deklaruar subjekti ka rezultuar se në datën 23.10.2015 para noteres M. N., deklaruesit K. Sh.¹ dhe M. K.² kanë deklaruar se *K. Sh. ka në pronësi një apartament me vendndodhje në Durrës, Lagjja ***, rruga “***”, për të cilin ka nënshkruar një kontratë me OSHEE-në për furnizimin me energji elektrike. Meqenëse ky apartament përdoret nga z. M. K., deklaruesi K. Sh. është dakord që për këtë ambient të zgjidhet kontrata e sipërcituar nga emri i tij dhe të lidhet në emër të z. M. K., duke konfirmuar një marrëdhënie përtej përdorimit të thjeshtë të këtij apartamenti prej prindërve të bashkëshortit dhe duke e bërë të largët dhe të paprovuar për asnjë periudhë kohore përdorimin prej tyre të*

¹Shtetasi K. Sh., i datëlindjes 13.11.1953, me kartë identiteti nr. ***.

²Shtetasi M. K., i datëlindjes 7.8.1943, me kartë identiteti nr. ***.

pasurisë e paluajtshme apartamentit të banimit me sip. 127 m², ndodhur në Lagjen Nr. ***, Durrës.

1.4. Bazuar në rrethanat e sipërcituara në referim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit, lidhur me burimin e tri kësteve të paguara për blerjen e kësaj pasurie, i ka kaluar barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, për sa vijon:

- Lidhur me këstin e parë të paguar në shumën 5.298.582,8 lekë – subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues kohën e pagesës së këstit të parë të apartamentit nga prindërit e bashkëshortit në shumën 5.298.582,8 lekë dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm të kësaj shume.
- Lidhur me këstin e dytë të paguar nga subjekti dhe bashkëshorti në vlerën 2.000.000 lekë – subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2014 dhe, për rrjedhojë, kjo gjendje *cash* nuk mund të jetë përdorur si burim krijimi i kësaj pasurie.
- Lidhur me këstin e tretë të paguar prej 2.486.400 lekësh është likuiduar nga znj. V. K., e cila e ka marrë hua prej znj. Sh. M., me deklaratën noteriale të datës 14.11.2014. Nga analizimi i të dhënave bankare të prindërve të subjektit rezulton se ato kanë të njëjtën vlerë në llogarite e tyre, duke mos provuar burimin e ligjshëm të shumës të depozituar *cash*, e cila pas depozitimit ju dha hua prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për pagimin e këstit të kësaj pasurie para marrjes së kredisë bankare.

2. Lidhur me këstin e parë në vlerën 5.298.582,8 lekë

2.1. Në bazë të deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar: kësti i parë prej 5.298.582,8 lekësh është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës paraprake të sipërmarrjes në ambientet e shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., në datën 25.2.2011, nga znj. V. K., sipas mandatpagesës nr. ***, datë 25.2.2011.

2.2. Në bazë të hetimit referuar një kontrate tjetër premtim-shitje lidhur në datën 24.1.2018³ me palë shoqëria “****” sh.p.k. (në cilësinë e shitësit) dhe znj. Sh. K. (në cilësinë e blerësit), rezulton se janë lëshuar: (i) mandatpagesa nr. ***, datë 21.2.2011,

2.3. Sa më sipër, rezulton se me mandatpagesën me nr. serial ***, datë 25.2.2011, shoqëria ka arkëtuar vlerën 5.298.582,8 lekë nga znj. V. K. për likuidim kësti apartamenti dhe me mandatpagesën me nr. serial ***, datë 21.2.2011, ka arkëtuar nga znj. Sh. K. shumën 20.000 euro për likuidim kësti apartamenti.

2.4. Referuar numrave të mandateve të paraqitura nga subjekti: mandatpagesa me datë 25.2.2011 ka nr. ***, datë 25.2.2011; mandatpagesa me datë 14.11.2014 ka nr. ***; dhe mandatpagesa me datë 14.11.2014 ka nr. ***.

2.5. Bazuar në analizimin e sa më lart, mandat-pagesa e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si dokument justifikues për pagesën e këstit të apartamentit në vitin 2011, referuar vetë numrit

³Pjesë e dokumentacionit të vendosur në dispozicion me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.5.2020, të ASHK-së Durrës.

rendor të saj, si dhe datës së lëshimit, renditjes të parregullt, dhe mospërputhje të konstatuara—ajo, nuk provon se shuma e kështit të parë është paguar në vitin 2011

2.6. Pagimi i kështit të parë prej 5.298.583 lekësh nga znj. V. K., ngelet i paprovuar jo vetëm me dokumentacion provues financiar por edhe me dokumentacion provues ligjor për sa kohë nga analizimi i përmbajtjes së kontratës së sipërmarrjes të vitit 2014, rezulton se ky akt nuk përbën një shtesë të kontratës së sipërmarrjes datë 2011 dhe nuk është një pjesë integrale e saj, por qëndron si një kontratë e mëvetshme e lidhur ndërmjet palëve të ndryshme.

2.6.1 Kontrata e sipërmarrjes, në datën 5.12.2014, ka ndryshime jo vetëm për sa i përket palës porositore ku, përveç znj. V. K., porositës janë edhe z. I. K. dhe znj. Edina Kurti, por edhe mbi çmimin e dakordësuar për apartamentin nga 14.115.000 lekë, në 9.784.982,8 lekë.

2.7..Ndryshimi i palëve dhe vlerave përkatëse apo dhe çmimit siç edhe përcaktimi i tyre, kanë sjellë një marrëveshje tjetër mes gjithë palëve dhe në këto rrethana, kontrata e vitit 2011 nuk mund të jetë një bazë për të ndërtuar fakte mbi marrëdhënien e re kontraktore.

Lidhur me burimin e ligjshëm të shumës 5.298.582,8 lekë

2.8. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit, për kështin e parë në shumën 5.298.583 lekë të likuiduar në datën 25.2.2011, nuk ka deklaruar burim të të ardhurave.

2.9.Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 11.2.2016, e pyetur në lidhje me burimin e të ardhurave të znj. V. K. (pyetja ***), subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Një pjesë e shumës prej 5.298.582 lekësh e ka nga të ardhurat e punës që vjehri dhe vjehrra kanë bërë në Greqi në vitet 1993 - 2003. Gjithashtu, sqaroj se vjehri im M. K. prej vitit 2001 ka punuar në detyrën e drejtorit të Agjencisë Detare Shtetërore Taulantia sh.a., si dhe M. dhe V. K. kanë bërë bashkim familjar në Kanada me vajzën e tyre që jeton prej shumë vitesh në Kanada, ku janë pajisur edhe me karta qëndrimi dhe marrin një suplement pagesë mujore...”*.

2/10.Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka shtuar burimin e krijimit të deklaruar më sipër, duke deklaruar, ndër të tjera, se: *“...në lidhje me burimin e krijimit të shumës 5.298.583 lekë, pjesa më e madhe është nga kontributi i vajzës së tyre A. H., e cila jeton dhe punon në Kanada nga viti 2002 dhe aktualisht”*.

2.11.Ky burim nuk është deklaruar as në deklaratën *Vetting* dhe as në përgjigjet sqaruese në ILDKPKI në vitin 2016, kohë kur subjekti ka dhënë shpjegime të hollësishme mbi çdo pagesë të kryer dhe burimin e këtij apartamenti.

2.12.Në vijim të sa më sipër, për sa subjekti, pas përgjigjeve në pyetësor, ka shtuar burimin e deklaruar në vitin 2016 mbi të ardhurat e prindërve të bashkëshortit për krijimin e shumës 5.298.583 lekë (duke shtuar të ardhura nga kontributi i znj. A. H. në shumën 40.000 CAD), duke u mbështetur në vendimmarrjen e Kolegjit⁴, kam vlerësuar se ky burim të ardhurash dhe ky deklarim i subjektit, i kryer gjatë procesit të rivlerësimit, nuk mund të merret në konsideratë.

⁴Nr. 34/2019, datë 2.12.2019; nr. 2/2020, datë 27.2.2020: *“[...] Kolegji arsyeton se, referuar jurisprudencës së tij, deklarata noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaratave noteriale forcohet sidomos kur nuk mbështeten dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit [...]”*.

2.13. Bazuar në parashikimet e nenit 49, pika 1, germa “b” dhe pikës 4 të ligjit nr. 84/2016, deklaramet nuk janë në pajtueshmëri të dukshme me procesverbalin e vitit 2016 të ILDKPKI-së, në të cilin huaja nuk rezultoi e deklaruar me burim nga të ardhurat e motrës së bashkëshortit të subjektit dhe, përmbi të gjitha, nuk rezultoi të jetë e deklaruar si burim në deklaratën *Vetting*, rrethana këto që dobësojnë ndjeshëm vlerën provuese në kuptim të këtij procesi.

2.14. Për sa më sipërshtetuar lidhur me këtë burim krijimi, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë kohën e pagesës së shumës 5.298.582,8 lekë, si dhe nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të kësaj shume përdorur si burim krijimi.

3. Lidhur me këstin e dytë në vlerën 2.000.000 lekë

3.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti, për këstet e paguara për blerjen e apartamentit, ka deklaruar si burim për shumën 2.000.000 lekë të paguar prej saj dhe bashkëshortit nga gjendja *cash*.

3.2. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në datën 4.6.2012⁵, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 25.000 euro, me burim “*kryesisht nga puna e bashkëshortit në emigracion në vitet 1993 – 2003, puna e tij në Shqipëri dhe puna ime*”.

3.3. E pyetur më parë nga ILDKPKI-ja⁶ mbi burimin e krijimit të shumës 25.000 euro, të deklaruar si gjendje likuiditetesh *cash* në deklaratën para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *bashkëshorti i saj ka jetuar e punuar në Greqi në vitet 1993 – 2003 së bashku me familjen e tij. Duke u nisur nga kushtet e asaj kohe nuk disponojnë dokumente ligjore mbi këto të ardhura, por thekson së kjo shumë është burim i punës së vazhdueshme të bashkëshortit dhe familjes së tij*. Subjekti sqaron se ajo ka jetuar dhe jeton së bashku me bashkëshortin dhe prindërit e tij dhe kjo shumë ka burim të ardhurat e gjithë familjes.

3.4. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar në DPV/2014 pakësime apo ndryshime në gjendjen *cash* të saj dhe të bashkëshortit, deklaruar më parë.

3.5. Bazuar në pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, “Për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramet dhe burimit të ligjshëm të pasurisë”, deklaramet periodike kanë vlerën e provës në procesin e rivlerësimit dhe pakësimi i gjendjes *cash* i padeklaruar në vitin 2014 nuk mund të merret në konsideratë.

3.6. Në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, deklarata e pasurisë për vitin 2014 është provë që vërteton pranimin ose rrëzimin e pretendimeve të subjektit në proces.

3.7. Në analizë të DPV/2014, subjekti nuk ka deklaruar se ka pakësuar gjendjen *cash*, ndaj pretendimi i subjektit të rivlerësimit për pagimin e vlerës 2.000.000 lekë në vitin 2014 është i pambështetur në prova dhe në ligj.

3.8. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarameteve për një subjekt deklarimi matet vetëm përmes deklarameteve të sakta dhe të plota. Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim lidhur me deklarimin e çdo pasurie të paluajtshme, të

⁵Seksioni “deklarimi i interesave private pasuritë e paluajtshme/pasuritë e luajtshme”.

⁶Referohuni procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 11.2.2016, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2020, të ILDKPKI-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.1.2020).

luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

3.8.1 Formulari i miratuar i deklarimit të pasurisë përshkruan, më tej, mënyrën se si duhen deklaruar këto ndryshime, duke detyruar subjektet e deklarimit të deklarojnë në mënyrë të qartë çdo shtesë apo pakësim që përbën ndryshim të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme. Legjislacioni i sipërcituar përcakton detyrimin e zyrtarit deklarues të deklarojë gjendjen e parave *cash* dhe jo të nënkuptohet ekzistenca e tyre si diferencë apo shtesë e veprimeve financiare që mund të jenë kryer.

3.9.Përdorimi i gjendjes *cash*, i cili nuk është deklaruar si pakësim, është qartësuar dhe konsoliduar nga vendimmarrjet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku, ndër të tjera, Komisioni orientohet se: *“Për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen ...të mos prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklarata periodike [...]”*.

3.10.Duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit lidhur me deklarimin e kursimeve apo likuiditeteve *cash*, të cilat duhet të lexohen dhe llogariten ashtu sikurse janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore, kam vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë përdorimin e gjendjes *cash* si burim krijimi për pagesën e këstit të dytë të këtij apartamenti.

Lidhur me burimin e ligjshëm të shumës 2.000.000 lekë

3.11.Edhe për sa i përket ligjshmërisë së burimit të krijimit të shumës së deklaruar nga subjekti si e ardhur nga emigracioni, subjekti ka pretenduar se bashkëshorti i saj, ka të ardhurat totale të krijuara prej tij nga puna në emigracion në shtetin grek për periudhën 1993 – 2003 në total 28.000 euro, të provuara me dokumentacion IKA.

3.12.Referuar shumës së deklaruar si kursim në vitin 2012 prej 25.000 euro si dhe pagesës së kryer për blerjen e pasurisë së parë apartament banimi me sipërfaqe 66m², Lagjen ***, sektori ***, ***, Durrës ku bashkëshorti ka kontribuar me të ardhurat nga emigracioni në shumën 5.000 euro, vlera e deklaruar si burim nga të ardhurat nga emigracioni për blerjen e pasurive të paluatshme rezulton të jetë 30.000 euro, më e madhe se vlera e përfituar nga bashkeshorti në emigracion dhe e provuar për sa i përket ligjshmërisë.

3.13.Nëse mbahet në konsideratë logjika matematikore, sipas të cilës bashkeshoriti i subjektit ka pasur mundësi ta kursente këtë shumë të përfituar rezulton që ai të ketë pasur mundësi të jetojë, pa shpenzuar as edhe 10 euro në ditë, shumë e cila është vlera e perafert e përlllogaritur ditore e shumës prej 28.000 euro për një periudhë 10 vjeçare në shtetin grek.

3.14.Për sa i përket të ardhurave të deklaruara si të përfituara nga bashkëpunimi me shtëpinë diskografike, koncertet e dhëna në Greqi, Qipro, etj., muzika e bërë *live* me grupin nëpër evente të ndryshme në Greqi dhe publikimi i albumit, ndërsa pjesën tjetër të të ardhurave e ka përfituar nga puna si emigrant i paregjistruar, këto të ardhura mbeten vetëm në nivelin deklarativ, duke mos u provuar për sa i përket ligjshmërisë së tyre.

3.15.Për sa më sipër arsyetuar lidhur me këtë burim krijimi, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë përdorimin e gjendjes *cash*, si burim krijimi për pagesën e këstit të dytë të këtij apartamenti si burimin i ligjshëm lidhur me këstin e dytë në vlerën 2.000.000 lekë.

3. Lidhur me këstin e tretë në vlerën 2.486.400 lekë

3.1 Ky kest është likuiduar nga znj. V. K., e cila e ka marrë hua prej znj. Sh. M. me deklaratën noteriale të datës 14.11.2014, sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes dhe deklaratës noteriale të hartuar mes palëve.

3.2. Në deklaratë noteriale të datës 14.11.2014, shtetasja V. K. ka konfirmuar marrjen e një huaje nga znj. Sh. M. në shumën 2.486.400 lekë, e cila ka shërbyer për pagimin e këstit të tretë të apartamentit.

3.3.Udhëzimi i ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”, në pikat 7, 15, 18 dhe 22 përcakton: “*Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojë burimin në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri në momentin e fitimit të tyre*”.

3.4. Në pjesën “Deklarimi i pasurisë nga persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit”, përcaktohet: “*Persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.*

Personat e tjerë të lidhur, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë në Inspektoratin e Lartë, me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm të Deklarimit të Pasurive të Paluajtshme”. Gjithashtu në këtë formular, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, sqarohet: “*Objekti i deklarimit: të gjitha pasuritë e akumuluarra ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur*”.

3.5.Për sa kohë subjekti nuk e ka deklaruar këtë hua si burim krijimi për këtë apartament, ajo ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me burimin, pasi në deklarimin në deklaratën *Vetting* të kësaj pasurie nuk është deklaruar hua nga znj. Sh. M., shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri.

3.6.Përveç pasaktësisë në deklarim lidhur me burimin e krijimit të shumës së dhënë hua nga nëna e saj, subjekti, në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, ndër të tjera, deklaroi se: “*Meqenëse nëna ime Sh. M. dhe babai kishin llogari rrjedhëse prej vitesh në BKT i dha shumën hua prej 2.486.400 lekësh V. K. me deklaratën noteriale datë 14.11.2014 dhe po në këtë datë është bërë pagesa prej 2.486.400 lekësh te shoqëria ‘***’*”.

3.7. Ky deklaram lidhur me burimin e krijimit të shumës së dhënë hua, përdorur si burim krijimi për këtë pasuri, nuk mbështetet nga faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, sipas të cilit depozita në BKT në emër të prindërve të subjektit prej 1.300.000 lekësh nuk është pakësuar dhe ka pasur të njëjtën vlerë ndër vite, sikundër edhe depozita në “Intesa Sanpaolo Bank” në vlerën 600.000 lekë, e cila nuk është pakësuar dhe vazhdon të qëndrojë në bankë, duke mos provuar deklaramin e subjektit se si burim për huan kanë shërbyer të ardhurat në llogarinë bankare të prindërve të saj.

Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 2.486.400 lekë

3.8. Sipas lëvizjeve të llogarisë në emër të znj. V. K. ose z. E. M. në këtë bankë, rezultojnë veprimet si vijon: (i) në datën 12.8.2014 është transferuar nga z. I. K. shuma 8.035,9 euro; (ii) në datën 12.8.2014 është depozituar *cash* nga znj. Sh. M. shuma 12.000 euro.

3.9. Në analizë të likuiditeteve që kanë shërbyer për dhënien e huas lidhur me burimin e krijimit të tyre, rezulton se bashkëshorti i subjektit, z. I. K., e ka depozituar në datën 12.8.2014 shumën 8.035,9 euro, të cilën ia ka transferuar nënës së subjektit, e cila ë pas do t’ia jepte hua nënës së tij. Lidhur me këtë depozitim subjekti ka deklaruar se e ka burimin nga shuma e gjendjes *cash* të deklaruar. Megjithatë në vitin 2014 nuk ka pakësim të gjendjes *cash* për krijimin e kësaj llogarie, subjekti dhe bashkëshorti kanë pamundësi financiare për krijimin e këtij depozitimi, duke mos provuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume, përdorur si burim për dhënien e huas.

3.10. Për sa i përket shumës së depozituar *cash* prej 12.000 euro nga nëna e bashkëshortit të subjektit, për sa depozita në BKT në emër të prindërve të subjektit prej 1.300.000 lekësh, krijuar me të njëjtën vlerë ndër vite, si dhe depozita në “Intesa Sanpaolo Bank” në vlerën 600.000 lekë, vazhdon të qëndrojë në bankë, jo vetëm nuk provohet se ka pasur si burim të ardhurat në llogarinë bankare të prindërve të saj, por edhe nuk provohet nga analiza e kryer e prindërve të subjektit për depozitim të kësaj shume, rezulton se subjekti nuk ka arritur të provojë as burimin e ligjshëm të këtij depozitimi, përdorur për dhënien e huas.

3.11. Në lidhje me burimin e të ardhurave për krijimin e shumës së dhënë hua nga nëna e saj në datën 14.11.2014, subjekti i rivlerësimit⁷, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Burimi i të ardhurave të nënës dhe babait tim në këtë llogari të përbashkët të tyre ka qenë puna e babait ndër vite dhe kontributi i vëllezërve. Vëllai i madh I. M. është shtetas amerikan ku punon dhe jeton në New York, prej mbi 20-vite”*, për sa vëllai i subjektit është shtuar si burim gjatë hetimit administrativ dhe është një deklaram i ndryshëm i burimit nga ai i deklaruar në pyetësorin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2016, kam vlerësuar se ky burim nuk mund të merret në konsideratë.

3.12. Për sa më sipër arsyetuar lidhur me këtë burim krijimi, kam arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të shumës prej 2.486.400 lekësh, paguar si këst i tretë për këtë pasuri të paluajtshme, si dhe ka deklarim të pasaktë pasi nuk është deklaruar huaja e marrë e përdorur si burim.

3.14. Në përmbyllje të vlerësimit të kontrollit të kësaj pasurie apartament, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në 2/3 pjesë takuese, kam arritur në konkluzionin se

⁷Në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie situatë faktike e cila kualifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

4. Lidhur me Kontratë Porosie me * dhe *** rep/kol, datë 19.12.2014.**

4.1. Nga analizimi i Kontratës së Porosisë, rezulton se me datë 19 Dhjetor 2014 përpara noterit F. H. me seli ne Durres, Rruga “***”, palët kontraktuese si vijon: (i) Shoqëria *** shpk, regjistruar pranë QKR me NIPT ***, përfaqësuar nga administratori i saj z. A. M. i biri i S. dhe i Da., i datëlindjes 01.03.1974, lindur në Durrës dhe banues në lagjen nr.***, Durrës në cilësinë e porositesit dhe (ii) Z. I. K., i biri M. dhe V., i datëlindjes 18.07.1975, lindur në Tiranë dhe banues në Lagjen nr.***, Rruga ***, Durrës në cilësinë e të porositurit, vendosën në bazë të nenit 913 e vijues të Kodit Civil, përpilimin e Kontratës së Porosisë sipas termave si vijon:

4.2.Sipas objektit të kontratës së porosisë, Z. I. K. merr përsipër ndihmën në fushën e menaxhimit, administrimit, rekalmimit, kërkimit, gjetjes së tregut të shitjeve brenda dhe jashtë vendit të produkteve që tregton shoqëria dhe realizimin e shitjes së këtyre produkteve duke gjetur pasqyrim në rritjen e performancës së shoqërisë në tregun vendas dhe të huaj dhe zgjerimin e aktivitetit tregtar të saj, dhe kontrata do ti shtrijë efektet për një periudhë 5 vjecare pas nënshkrimit të saj nga palët me të drejtë ripërritje.

4.3.Më tej, në kontratë parashikohet se për shërbimin e bërë sipas objektit të kontratës, porositesi do të paguaj çdo muaj në favor të palës së Porositur, vlerën prej 10% të fitimit real të ardhur nga aktiviteti i shoqërisë në fushën e tregtisë së mallrave industriale, tregtimin me shumice dhe pakicë të pajisjeve elektroshtëpiake duke përfshirë dhe pagën mujore të tij.

4.4.Pyetur për këtë marrëdhënie, subjekti ka deklaruar se: *“në lidhje me kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol, datë 19.12.2014, të lidhur midis palëve, bashkëshorti në cilësinë e të Porositurit dhe shoqërisë “***” shpk në cilësinë e Porositësit, sqaroj Komisionin se bashkëshorti ra dakord me përfaqësuesin ligjor të shoqërisë z. A. M., të nënshkruante këtë kontratë porosie ose shërbimi me qëllim arritjen e objektivit që synonte përfaqësuesi ligjor, rritja e të ardhurave nga tregëtimi i produkteve dhe marrja e përfaqësimit të një brandi të ri pajisjesh elektro shtëpiake. Shoqëria “***” shpk nuk pati kapacitetet financiare dhe logjistike për rritjen e furnizimeve nga furnitorët e huaj dhe kushteve për të marrë përfaqësimin e këtij brandi të ri. Për këtë arsye midis palëve, në ambientet e shoqërisë, në dt.30.01.2015 u nënshkrua revokimi i kontratës së porosisë.*

*Në kushtet kur bashkëshorti i kishte shkëputur marrdhëniet e punësimit me shoqërinë “***” shpk, nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “***” shpk, z. A. M. ju propozua të lidhte një marrdhënie punësimi me kohë të plotë dhe të fillonin të punonin për arritjen e objektivave të shoqërisë. Në këtë mënyrë bashkëshorti ka pranuar të fillojë punë me kohë të plotë në shoqërinë “***” shpk. Marrdhënia e punësimit ka filluar në fillim të muajit Shkurt 2015 dhe është shkëputur përfundimisht në Janar 2018.*

Bashkëshorti nuk përfitoj asnjë të ardhur nga kjo kontratë shërbimi, as për vitin 2014 dhe as për vitin 2015, pasi kjo kontratë nuk filloj të zbatohej asnjëherë. Për këtë arsye nuk është deklaruar prej meje në DPV-në e vitit 2014, apo në periudhat e tjera vijuese. Në rubrikën “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private” është kërkuar të deklarohet/përshkruhet në lidhje me të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë ta ardhura personale dhe për bashkëshortin. Përshkrimi i të ardhurave dhe shuma e tyre.

Në DPV-në e vitit 2014 detyrimi ka qenë për të deklaruar të ardhurat e realizuara gjatë këtij viti dhe jo një marrëdhënie shërbimi e cila nuk u zbatua asnjëherë. Për sa kohë që kjo kontratë nuk gjeneroi asnjë të ardhur apo të drejtë mbi ndonjë shumë, nuk ka qenë detyrim prej meje të deklarohej kjo marrëdhënie”.

4.5.Nënshkrimi i kontratës së porosisë nga ana e bashkëshortit të subjektit në vitin 2014 duhet të deklarohej në deklarinin periodik të vitit 2014, sikurse edhe revokimi i kontratës së porosisë qofte dhe me nje dokument hartuar në zyrat e shoqërisë duhej deklaruar ne vitin 2015.

4.6.Referuar të dhënave në QKB-se (*ekstrakti historik i lëshuar nga QKR nuk pasqyron vetëm gjeneralitetet e shoqërisë datë regjistrimi, emër, formë ligjore, seli, aksionarë, përfaqësues ligjor etj...por të gjitha veprimet e kryera në mënyrë kronologjike në lidhje me shoqërinë*) rezulton se shoqëria “***” sh.p.k ka pasur fitime të deklaruara në bilancet kontabel përgjate ketyre viteve dhe deklarimet e subjektit të bashkëshorti se nuk përfitoj asnjë të ardhur nga kjo kontratë porosie/shërbimi, as për vitin 2014 dhe as për vitin 2015, nuk gjejnë mbështetje në dokumentacionin ligjor provues që rezultoi nga hetimi administrativ, pasi në vitin 2016 në deklarinin ne ILDKPI ka deklaruar vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë nr.*** datë 18.02.2018, nëpërmjet të cilit ortaku i vetëm i shoqërisë “***” shpk ka shpërblyer administratorin Z. I. K. në përqindje me fitimin e realizuar nga shoqëria gjatë vitit 2017 për shumën 7.925 euro.

4.7. Sa më sipër personi i lidhur/ bashkëshorti i subjektit ka shmangur nga detyrimi për deklarin të ardhura të pritshme të dakordesuara apo përfituara bazuar në kontratën e porosise/shërbimit të lidhur mes palëve dhe nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe janë ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë te ardhurat në referim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

5. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga analizimi i të dhënave të administruara gjatë hetimit, unë, si relatore në pakicë, çmoj se shkeljet apo mangësitë profesionale të konstatuara pengojnë kualifikimin e subjektit si të përshtatshëm profesionalisht, kjo, pasi përmbajtja e problematikave profesionale të konstatuara përgjatë hetimit administrativ, përfshirë numrin e çështjeve, në të cilat janë evidentuar (në raport me dosjet e shqyrtuara), në vlerësimin tim mjaftojnë për t’i konsideruar në vlerësimin tërësor lidhur me këtë subjekt rivlerësimi si vijon.

5.1 Vendimi për mosfillimin e procedimit penal nr. * të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime lidhur me vendimin për mosfillimin e procedimit penal nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, nga analizimi i të cilit u konstatua se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë masat për ruajtjen e vendit të ngjarjes, fiksimit e gjurmëve dhe provave materiale, sikurse parashikon udhëzimi nr. ***, datë 24.1.2001, “Për rregulla të detyrueshme mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, kryerjes së autopsisë, ekzaminimeve dhe analizave; si dhe (ii) nga aktet e përfshira në fashikull nuk konstatohet dërgimi dhe marrja dijani nga palët e interesuara të vendimit të mosfillimit sipas nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, duke iu mohuar, kësisoj, palëve të drejtën për të realizuar të gjitha kërkesat kushtetuese e ligjore të një procesi të rregullt ligjor.

5.1.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka parashtruar se: *“Materiali kallëzues më është caktuar me short, duke u njohur me të me datë 2.3.2016 dhe veprimet hetimore janë kryer nga policia gjyqësore ditën e ngjarjes më 27.2.2016. Nga policia gjyqësore janë kryer veprimet e para si këqyrja e kufomës, vendim ekspertimi mjeko-ligjor, raport shërbim ngjarjeje etj. Gjithashtu është pyetur djali i të ndjerit, i cili nuk ka pasur pretendime për ngjarjen, pasi prindërit jetonin vetëm në shtëpi. Nga këqyrja e kufomës nuk janë evidentuar shenja dhune në pjesë të trupit. Ndërsa sa i përket njoftimit të vendimit të mosfillimit është miratuar nga drejtuesi dhe i është dërguar për njoftim familjarëve të të ndjerit me shkresën nr. ***, datë 7.4.2016”*.

5.1.2. Arsyetimi ligjor

Subjekti nuk dha shpjegime bindëse në lidhje me mosmarrjen e masave për ruajtjen e vendit të ngjarjes, fiksimin e gjurmëve dhe provave materiale, sikurse parashikon udhëzimi nr. ***, datë 24.1.2001, *“Për rregulla të detyrueshme mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, kryerjes së autopsisë ekzaminimeve dhe analizave”*. Qëndrimi i subjektit se materiali kallëzues i është caktuar me short dhe veprimet hetimore janë kryer nga policia gjyqësore ditën e ngjarjes nuk qëndron, pasi pika 1 e nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale parashikon shprehimisht se prokurori, ndër të tjera, bën hetime dhe kontrollon hetimet paraprake⁸. Ky parashikim konfirmohet edhe më tej në pikën 1 të nenit 304 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit *prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm*. Gjithashtu, edhe ligji organik i zbatueshëm nr. 8737/2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar,⁹ në nenin 56/a të tij përcakton se *prokurorët drejtojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë hetimore të policisë gjyqësore, duke garantuar respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut*. Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, si dhe për të mbledhur provat e kërkuara me ligj.

5.2. Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. * i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë për veprën penale “fshehje e të ardhurave” të parashikuara nga neni 180 i Kodit Penal**

Subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime lidhur me vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, nga analizimi i të cilit u konstatua se: (i) subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale sipas kërkesave të pikës 3 të udhëzimit nr. ***, datë 22.11.2005, *“Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”* i ndryshuar, të Prokurorit të Përgjithshëm, pavarësisht nga fakti që në referimin e policisë gjyqësore është evidentuar emri i personit, i cili mendohet se lidhet me veprën penale; (ii) për një periudhë 4-mujore policia gjyqësore nuk ka realizuar veprimet sipas urdhërdelegimit dhe, më tej, janë kryer disa prej tyre. Në relacionin mbi përfundimin e procedimit penal, oficeri i policisë gjyqësore ka relatuar, ndër të tjera, se dosja penale është marrë dorazi nga subjekti i rivlerësimit vetëm në muajin gusht të vitit 2015,

⁸Pika 1 e nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale në fuqi.

⁹Ligji në fuqi.

pavarësisht se urdhërdelegimi mban datën 1.4.2015; (iii) shkresa nr. *** prot., datë 9.10.2015 e Drejtuesit të Prokurorisë evidenton zvarritje në hetim lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 6.3.2015.

5.2.1.Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka parashtruar se: *“Sipas formularit të Drejtuesit të Prokurorisë, në datën 6.3.2016, është përpiluar urdhri për regjistrimin e kallëzimit penal me nr.***, datë 6.3.2015, duke u cilësuar se materiali kallëzues duhet të regjistrohet për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal. Gjatë kryerjes së veprimeve të para hetimore dhe nga tërësia e materialit të referuar nga policia gjyqësore nuk ka pasur indicie për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale. Gjithashtu, subjekti sqaron se ka ushtruar kontrollin periodik të dosjes, pasi referuar urdhërdelegimit, veprimet hetimore duhet të kryheshin deri në datën 1.7.2015. Meqenëse dosja nuk ishte dërguar deri në këtë datë, në muajin gusht i është kërkuar oficerit të policisë gjyqësore të dërgojë dosjen me veprimet hetimore dhe relacionin shpjegues mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve. Pas studimit të dosjes dhe veprimeve të kryera nga oficeri, dosja i është deleguar sërish oficerit, pasi nuk ishin kryer të gjitha veprimet hetimore”.*

5.2.2.Arsyetimi ligjor

Në aktet e referuara nga policia gjyqësore (administruar në fashikullin penal) emri i personit që i atribuohet vepra penale rezulton i qartë. Regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale është një detyrim ligjor i parashikuar nga neni 287 i Kodit të Procedurës Penale¹⁰.

Regjistrimi i emrit të personit lidhet edhe me respektimin e afateve të parashikuara nga neni 323 i këtij Kodi dhe për shmangien e abuzimeve me zvarritjen e hetimeve në momentin që ky emër nuk regjistrohet.

Nisur edhe nga arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹¹, si dhe nga fakti që në referimin e veprës penale është evidentuar emri i personit, prokurori duhet të kishte vijuar me regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale dhe nga ky moment të fillonin afatet e hetimeve, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale.

Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me vonesat janë të pabazuara pasi, referuar dispozitave ligjore, është detyrë e prokurorit që të marrë të gjitha masat për kryerjen e veprimeve hetimore në kohë. Subjekti nuk mund të shkarkojë nga përgjegjësia, duke deklaruar

¹⁰Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.

¹¹Vendimi unifikues nr. 3, viti 2002, i Gjykatës së Lartë ku është arsyetuar: *“... termin ‘person të cilit i atribuohet vepra penale’ e gjejmë në nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale që flet për mënyrën si njoftohet e merr dijëni për veprën penale prokurori dhe policia. Kur njoftuesi mendon se e di se kush është autori i veprës penale, prokurori shënon në regjistrin që mbahet për njoftimin e veprave penale emrin e personit që tregon kallëzuesi, se është ose mund të jetë autor i veprës penale. Nuk ka asnjë dyshim se ky emërtim i përket fazës fillestare të procedimit penal – termi ‘person të cilit i atribuohet vepra penale’, i marrë në kontekstin e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale plus momentin procedural në të cilin përdoret, kuptohet se nuk mund të barazohet as me termin ‘person ndaj të cilit zhvillohen hetime’ dhe as me termin ‘i pandehur’. Emri i personit, të cilit i atribuohet vepra penale, shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur kallëzuesi mendon se e di se kush është autori i krimit. Por kjo nuk do të thotë se ai është vërtet autor i veprës penale. Nëse vërtet personi, të cilit i atribuohet vepra penale, është apo jo autor i veprës penale, do të dalë nga një hetim i plotë i gjithanshëm e në përputhje me ligjin [...] arrihet në përfundimin se figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale, që nga momenti i njoftimit të saj tek prokurori e deri në momentin e përfundimit të hetimeve (neni 327), evoluon nga ‘person të cilit i atribuohet vepra penale’ në ‘person ndaj të cilit zhvillohen hetime’ dhe së fundi në ‘i pandehur’, pavarësisht së çështja pushohet (neni 328) apo dërgohet për gjykim (neni 331).*

si arsye vonesat në veprimet e oficerëve të policisë gjyqësore (të cilët në bazë të nenit 30/2 të Kodit të Procedurës Penale janë të detyruar të zbatojnë urdhrat e prokurorit) dhe këto mosveprime të subjektit kanë ndikuar në mungesën e hetimeve.

5.3. Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. * i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime lidhur me vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, nga analizimi i të cilit u konstatua se: (i) subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale sipas kërkesave të pikës 3 të udhëzimit nr. ***, datë 22.11.2005, i ndryshuar, të Prokurorit të Përgjithshëm, pavarësisht nga fakti që në referimin e policisë gjyqësore është evidentuar emri i personit, i cili mendohet se lidhet me veprën penale; (ii) nga aktet e procedimit penal nuk evidentohet të ketë urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore; (iii) subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal më 29.12.2014, ndërkohë që shkresa e Drejtuesit të Prokurorisë e datës 7.8.2014 urdhëron regjistrimin brenda afatit 30-ditor. Nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues deri në momentin e urdhërimit të regjistrimit të procedimit penal ka kaluar një periudhë prej rreth 4 muajsh. Gjithashtu konstatohet se urdhri i regjistrimit të procedimit penal nga prokurori, datë 29.12.2014, është marrë në të njëjtën datë që është bërë aplikimi pranë ALUIZN-it nga shtetasi I. Z.; (iv) në vendimin për pushimin e çështjes datë 10.6.2015, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, argumenton se duke qenë se sipas formularit të deklarimit rezulton se ndërtimi është kryer në vitin 2012, ligji nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie” e përjashton nga ndjekja penale shtetasin I. X.. Në ligjin nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, në nenin 5 është parashikuar pushimi i ndjekjes penale, i cili kërkon plotësimin e dy kushteve në mënyrë kumulative – së pari, vepra penale të jetë kryer përpara datës 30.12.2013 dhe – së dyti, vepra penale të parashikojë një dënim deri në dy vjet ose çdolloj dënimi tjetër më të butë. Si rrjedhim, konstatohet se vepra penale nuk mund të futet në atë bashkësi veprash që përfshihen në nenin 5 të ligjit të sipërpërmendur, pasi kallëzimi i ardhur nga Komisariati i Policisë Kavajë për kryerjen e veprës penale “ndërtim i paligjshëm” mban datën 7.8.2014.

5.3.1. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka parashtruar se: *“Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe, në të njëjtën kohë, ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. Në këto kushte është urdhëruar vetëm regjistrimi i procedimit penal, duke ngarkuar me hetimin oficerin e policisë gjyqësore, që ka kryer veprimet e para hetimore, si dhe cilësore edhe në formularin e Drejtuesit të Prokurorisë. Në fashikull nuk ka urdhër shkresor në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore të deleguara për OPGJ-në për shkak të ngarkesës dhe hetimit në dinamikë, ka pasur raste që OPGJ-së i janë deleguar veprimet edhe verbalisht, si në rastin konkret. Nga këqyrja dhe administrimi i praktikës tek ALUIZN-i, rezulton se praktika në emër të shtetasit I. X., me nr. *** prot., datë 29.12.2014, kur kjo datë rastësisht përkon me datën e regjistrimit të procedimit penal, por në një kohë kur kallëzimi është regjistruar me datë 7.8.2014 dhe çështja ishte në hetim. Pushimi i hetimit është vendosur bazuar në nenin 328, germa ‘b’ e Kodit të Procedurës Penale, bazuar në aktekspertimin se ndërtimi është kryer që në vitin 2012, pra përpara datës 30.12.2013”.*

5.3.2. Arsyetimi ligjor

Referuar në sa më lart, regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale është një detyrim ligjor i parashikuar nga neni 287 i Kodit të Procedurës Penale, pasi lidhet edhe me respektimin e afateve të parashikuara nga neni 323 i këtij Kodi dhe për shmangien e abuzimeve me zvarritjen e hetimeve në momentin që ky emër nuk regjistrohet.

Subjekti i rivlerësimit ka bërë arsyetim të gabuar dhe kontradiktor në vendimin e pushimit, duke referuar njëkohësisht si bazë ligjore për pushimin e vendimit nenin 328, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, si dhe ligjin nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”. Fakti që subjekti pranon se, pavarësisht interpretimit në vendimin e pushimit, procedimi penal është pushuar bazuar vetëm në nenin 328, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale tregon se ky subjekt ka mangësi në aspektin e arsyetimit ligjor në marrjen e vendimeve.

Në përgjigjet e dhëna pas kalimit të barrës së provës nuk rezulton që nga subjekti të jenë dhënë shpjegime mbi arsyet se përse ka kaluar një periudhë prej rreth 4 muajsh nga momenti i regjistrimit të procedimit penal (datë 29.12.2014) deri në momentin e urdhërimit të regjistrimit të materialit kallëzues të Drejtuesit të Prokurorisë (datë 7.8.2014).

Shpjegimi i subjektit se praktika me nr. *** prot., datë 29.12.2014, në emër të shtetasit I. X., rastësisht përkon me datën e regjistrimit të procedimit penal, nuk provon arsyet e zvarritjes së regjistrimit të procedimit penal për rreth 4 muaj, prej së cilës u mundësua përfitimi i këtij shtetasi nga ligji “Për amnistinë”.

5.4. Mbi informacionin e marrë nga portali [https://top-channel.tv/*](https://top-channel.tv/***) :** *“Një 29-vjeçar ishte dënuar me 6 vjet e 8 muaj burg nga Gjykata e Apelit e Milanos, Itali. Ky vendim u ekzekutua në shtetin shqiptar dhe prej vitit 2017 qytetari ndodhej në burg. Por, në vitin 2018 Gjykata Kushtetuese Italiane ia uli dënimin, nga 6 vjet e 8 muaj burg në 5 vjet e 3 muaj burg. Vendimi i Kushtetueses Italiane mbërriti në Shqipëri në vitin 2020 në Ministrinë e Drejtësisë dhe, më pas, në Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe në burgun e Rrogozhinës. Në vitin 2020, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë tentoi që të ‘njohë’ këtë vendim në gjykatë, por u rrëzua me arsyetimin se ‘nuk ishte bërë kërkesa në mënyrën e duhur’. Prokurorja ‘harroi’ të korrigojë gabimin apo ta apelonte, pasi u transferua në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës. Dhe, gjatë kësaj kohe, gjykata dhe prokuroria i kanë rrëzuar kërkesat e mbrojtjes për shuarje mase. Aktualisht, me uljet e dënimit, qytetari duhet të ishte liruar nga burgun në fillim të muajit dhjetor 2021”.*

Subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime lidhur me denoncimin, nga analizimi i të cilit u konstatua se: (i) sipas vendimit datë 19.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, mjeti për të rregulluar situatën, i zgjedhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, është jo i duhuri, “një mjet i mundshëm për t’u përdorur në rastin konkret është rishikimi i vendimit që ka realizuar njohjen e vendimit penal të huaj”; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk e ka apeluar këtë vendim, me qëllim korrigjimin e objektit të kërkesës. Vendimi është rishikuar vetëm në datën 10.1.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, pas kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, përfaqësuar nga një subjekt tjetër rivlerësimi. Referuar dispozitivit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, datë 10.01.2022, rezulton se shtetasi Xh. K.

është mbajtur në burg tej kohës së caktuar në vendimin e ripërcaktimit të dënimit (rreth një javë tej afatit).

5.4.1. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka parashtruar se: *“Duke qenë se kjo kërkesë nuk ishte trajtuar ndonjëherë nga Prokuroria në lidhje me ripërcaktimin e masës së dënimit të dhënë, pra pa objekt/mjet konkret ligjor, u shtrua për diskutim në mbledhje me Drejtuesin e Prokurorisë dhe kolegët. Kërkesa është bërë nga ana ime më 27.5.2020, me objekt ‘njohjen e vendimit penal të huaj në zbatim të sentencës nr. 40/2019, të Gjykatës Kushtetuese Italiane’. Në datë 21.10.2019 gjyqtarit për hetimet paraprake pranë Gjykatës së Milanos, i cili ka ripërcaktuar dënimin me burgim prej 5 vjetësh. Kërkesa është bërë pikërisht për t’i dhënë rrugë praktikës nëpërmjet gjykatës ku, njëkohësisht, një kërkesë e tillë ishte paraqitur në gjykatë edhe nga mbrojtësi i shtetasit Xh. K.. Sipas vendimit datë 19.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, mjeti për të rregulluar situatën, i zgjedhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, është jo i duhuri, ‘një mjet i mundshëm për t’u përdorur në rastin konkret është rishikimi i vendimit që ka realizuar njohjen e vendimit penal të huaj’. Në lidhje me këtë vendim është njoftuar Drejtuesi i Prokurorisë, si dhe Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Gjithashtu, ndaj vendimit nuk është ushtruar ankimi as nga shtetasi, pasi mbrojtësi pohoi se do t’i drejtohej gjykatës me një kërkesë të re. Sqarohet se shtetasi Xh. K. nuk ka qëndruar në burg tej kohës së caktuar në vendimin e ripërcaktimit të dënimit për shkak të mosankimit të vendimit datë 19.10.2020 nga ana ime, vetë fakti që gjykata me vendimin datë 10.1.2022 ka vendosur pranimin e kërkesave të kërkuarit Xh. K., si dhe të Prokurorisë, tregon të kundërtën”.*

5.4.2. Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka bërë interpretim të gabuar në kërkesën e bërë më 27.5.2020, duke kërkuar njohjen e vendimit penal të huaj dhe jo rishikimin e vendimit, që ka realizuar njohjen e vendimit penal të huaj, sikurse është konstatuar edhe nëpërmjet vendimit datë 19.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, që arsyeton se mjeti për të rregulluar situatën, i zgjedhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, është jo i duhuri, “një mjet i mundshëm për t’u përdorur në rastin konkret është fakti që subjekti e pranonte vetë se duke qenë se kjo kërkesë nuk ishte trajtuar ndonjëherë nga Prokuroria në lidhje me ripërcaktimin e masës së dënimit të dhënë dhe, për këtë qëllim, u shtrua për diskutim në mbledhje me Drejtuesin e Prokurorisë dhe kolegët”, tregon se ky subjekt ka mangësi për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.

Subjekti i rivlerësimit nuk jep shpjegime bindëse se përse nuk ka vijuar me korigjimin e objektit të kërkesës, sikundër u përcaktua në vendimin datë 19.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Gjithashtu, shpjegimet e subjektit se ndaj vendimit nuk është ushtruar ankimi as nga shtetasi, pasi mbrojtësi do t’i drejtohej gjykatës me një kërkesë të re pas administrimit të të gjithë praktikës nga Autoritetet e Drejtësisë Italiane, nuk janë ligjore, pasi sipas kuptimit të tërësisë së dispozitave të Kreut III të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 53 të ligjit nr. 10193/2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar, është detyrë e prokurorit të procedojë me kërkesën për njohjen e vendimit penal të

huaj dhe t'i kërkojë autoriteteve të huaja, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, për plotësim dokumentacioni dhe jo e mbrojtësit të palës së dënuar.

Mosveprimet e subjektit kanë sjellë mbajtjen në burg të të dënuarit tej kohës së caktuar në vendimin e dënimit, duke përbërë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore, të sanksionuara në nenin 27 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Lidhur me kriterin profesional e denoncimet kam arritur në konkluzionin se veprimet e mosveprimet e subjektit të rivlerësimit në çështjet e analizuara më sipër cenojnë besimin e publikut te drejtësia dhe përbëjnë shkak që ndaj saj të aplikohet neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Pas shqyrtimit të provave në tërësinë e tyre kam arritur në konkluzionin se subjekti a) nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të saj, në referim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në referim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës; dhe b) ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia.

Xhensila PINE
Relatore/Kundër